

Qëllimi i kësaj flete informuese është të shpjegojë se çfarë nënkupton kur bëni një kërkesë për azil dhe përkufizimin ligjor të një refugjati.



Refugee
Legal
Support

ALBANIAN

ÇFARË DO TË THOTË TË KËRKOSH AZIL?

Kërkimi i Azilit

Kur kërkon azil:

- Ju po kërkon mbrojtje
- Ju po thoni që nuk ka sigurinë vendin tuaj të origjinës, prandaj nuk mund të ktheheni atje
- Ju po kërkon të drejtën për të qëndruar në vendin ku po kërkon azil, sepse nuk është e sigurt për ju që të ktheheni në vendin tuaj të origjinës

KUSH ËSHTË NJË "REFUGJAT" SIPAS LIGJIT?

Kush është një refugjat? Përkufizimi ligjor

Njerëzit largohen nga vendet e tyre për shumë arsye. Megjithatë, vetëm disa arsye përputhen me atë që ligji përkufizon si refugjat.



Ligji është Konventa e Refugjatëve 1951, që ndonjëherë quhet Konventa e Gjenevës



Ky është ligji që vendet përdorin kur përpiqen të vendosin nëse dikush është refugjat



146 vende në botë kanë nënshkruar këtë ligj, kështu që kjo do të thotë se përkufizimi i kush është refugjat është i njëjtë në të gjitha këto vende - qoftë nëse kërkon azil në Kanada, Greqi, Mbretëria e Bashkuar, Francë, Gjermani e kështu me radhë

Procedura e azilit - duke përfshirë dhe intervistat tuaja me autoritetet - është krijuar për të kuptuar nëse historia juaj përputhet me përkufizimin ligjor të një refugjati.

Sipas ligjit, ju jeni refugjat dhe duhet të ju jepet statusi i refugjatit, nëse:

1

Keni një frikë të bazuar mirë nga persekutimi

2

Kjo frikë nga persekutimi është për shkak të racës suaj, fesë, kombësisë, opinionit politik, grupit të veçantë shoqëror ("arsyet e Konventës")

3

Autoritetet në vendin tuaj nuk mund ose nuk duan t'ju mbrojnë

4

Ju nuk mund të jeni të sigurt në asnjë vend të vendit tuaj - nuk ka asnjë pjesë të sigurt ku mund të zhvendoseni

Secila nga këto pika do të shpjegohet në detaje më poshtë.

1

Keni një frikë të bazuar mirë nga persekutimi

Një frikë e bazuar mirë

Kjo do të thotë që ju jeni me të vërtetë të frikësuar dhe jeni të frikësuar nga diçka që mund të ndodhë me të vërtetë - nuk është një frikë iracionale ose e paarsyeshme.

...nga persekutimi

Kjo do të thotë që të drejtat tuaja themelore të njeriut do të mohohen ose do të shkelen ndjeshëm nëse ktheheni në shtëpi. Persekutimi nuk është domosdoshmërisht një rast në të cilin dikush që përpiqet t'ju vrasë, nuk është as domosdoshmërisht diçka fizike, megjithatë duhet të jetë diçka serioze. Kjo do të varet nga personi dhe shëndeti ose cënueshmëria e tij - për shembull, ajo që është persekutim për një fëmijë mund të mos jetë e njëjtë për një të rritur të shëndetshëm.

Diskriminimi ose vështirësitë në vendin tuaj të origjinës zakonisht nuk janë të mjaftueshme. Megjithatë, në disa raste mund të përbëjnë persekutim nëse janë shumë serioze.

Ajo që është e rëndësishme është nëse mund të persekutoheni në të ardhmen:

- Njerëzit shpesh mendojnë se për të qenë refugjat duhet të tregojnë se tashmë janë persekutuar në vendin e tyre. Kjo nuk kërkohet nga ligji.
- Është e mundur të merrni një vendim pozitiv dhe të njiheni si refugjat edhe nëse keni lënë vendin tuaj të origjinës para se t'ju ndodhte ndonjë gjë e keqe.
- Nëse tashmë jeni persekutuar në vendin tuaj të origjinës, është e rëndësishme ta përmendni këtë, sepse kjo mund të tregojë që e njëjta gjë mund të ndodhë përsëri në të ardhmen.
- Megjithatë, vetëm sepse autoritetet besojnë se tashmë jeni persekutuar nuk do të thotë se do të merrni një vendim pozitiv dhe se do të njiheni si refugjat.

Pyetja është nëse mund të persekutoheni në të ardhmen, nëse ktheheni në vendin tuaj.

Duhet të shpjegoni pse do të ishit ende në rrezik, nëse do të ktheheshit në vendin tuaj të origjinës. Nëse keni qenë në rrezik ose keni vuajtur në të kaluarën, kjo nuk është e mjaftueshme. Nëse nuk do të jeni në rrezik në të ardhmen, nuk do të merrni një vendim pozitiv.

Nga kush keni frikë se do të persekutoheni?

- Mund të jetë se keni frikë nga autoritetet në vendin tuaj të origjinës - ata në pushtet, qeveria, policia, ushtria, etj.
- Gjithashtu mund të keni frikë nga njerëz që nuk kanë lidhje me autoritetet - për shembull, grupe të ndryshme/rivale etnike, fetare apo politike, anëtarë të familjes ose komuniteti juaj.

Frika nga persekutimi mund të lindë pas largimit nga vendi juaj i origjinës

- Mund të jetë se kur keni lënë vendin tuaj nuk keni pasur frikë nga persekutimi, megjithatë që nga largimi, situata ka ndryshuar dhe do të ishte e rrezikshme për ju që të ktheheni.
- Kjo mund të jetë për shkak se situata në vendin tuaj ka ndryshuar.
- Mund të jetë gjithashtu sepse keni bërë gjëra që nga largimi nga vendi juaj që ju vënë në rrezik.

2

Arsyet për të cilat keni frikë nga persekutimi ("Arsyet e Konventës")

Për të marrë statusin e refugjatit, frika juaj nga persekutimi duhet të jetë për shkak të një (ose më shumë) prej këtyre arsyeve. Ato njihen si "Arsyet e Konventës" sepse janë të listuara në ligjin, Konventën e Refugjatëve:

- 1 Raca** juaj - përfshin etninë, fisin, ngjyrën e lëkurës.
- 2 Feja** juaj - kjo përfshin mos pasjen e një feje (ateizmi); humbjen e fesë së mëparshme (apostazia); ose ndërrimin e fesë (konvertimi).
- 3 Kombësia** juaj - shtetësia, ose identiteti juaj gjuhësor/kulturor edhe nëse nuk është i njohur ligjërisht. Nëse nuk keni shtetësi, kjo është gjithashtu e rëndësishme, quhet apatridia.
- 4 Opinioni juaj politik** - nuk është e nevojshme të jeni në një grup ose parti formale politike, por vetëm kundër autoriteteve.
- 5 Anëtarësia juaj në një grup të veçantë** shoqëror - kjo do të thotë që ju jeni ose do të trajtoheni ndryshe në vendin tuaj sepse ka diçka për ju ose identitetin tuaj që nuk mund ta ndryshoni (për shembull, orientimi seksual).

- Për të marrë statusin e refugjatit, arsyeja për të cilën keni frikë nga persekutimi duhet të lidhet me një nga arsyet e mësipërme.
- Ndoshta jeni në rrezik sepse një nga gjërat e mësipërme supozohet për ju - për shembull, njerëzit mendojnë se jeni homoseksual, por nuk jeni, ose qeveria mendon se jeni kundër tyre, por nuk jeni. Kjo ende llogaritet, gjëja e rëndësishme është se jeni në rrezik për shkak të një nga arsyet e mësipërme.
- Ndonjëherë më shumë se një nga arsyet e mësipërme mund të zbatohen në të njëjtën kohë.

Nëse keni frikë nga persekutimi për arsye të tjera përveç 5 të listuara më sipër, nuk është domosdoshmërisht përgjegjësia e vendit ku po kërkon azil që t'ju mbrojë.

Mbrojtje Plotësuese

Nëse kërkon azil në Evropë, por dëmi që keni frikë nuk lidhet me këto 5 "Arsyet e Konventës", mund të merrni një tjetër status të quajtur mbrojtje plotësuese.

- Të dy, statusi i refugjatit dhe mbrojtja plotësuese, quhen "status mbrojtjeje". Nëse ju jepet, keni të drejtën të qëndroni në vendin ku keni kërkuar azil sepse është kuptuar që nuk është e sigurt për ju të ktheheni në vendin tuaj.
- Gjatë kërimit të azilit, mund të shpjegoni pse jeni në rrezik në vendin tuaj të origjinës, por nuk mund të zgjidhni midis statusit të refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese.
- Nëse duhet të jepet mbrojtje plotësuese dikujt, kjo shqyrtohet sipas një ligji të ndryshëm (Direktiva 2011/95/EU), por nuk kërkohet një aplikim i veçantë, ju do të konsideroheni automatikisht për të dy statuset.
- Në shumicën e vendeve, përfitimet e marrjes së mbrojtjes plotësuese janë më të vogla se ato që lidhen me statusin e refugjatit.

Për të marrë mbrojtje plotësuese duhet të ketë një rrezik real që do të vuani dëmtime serioze. Shembuj të dëmtimeve serioze përfshijnë: dënimin me vdekje/ekzekutimin, torturën, dhunën në konfliktin e armatosur që është aq e keqe sa ndikon.

Për të marrë statusin e refugjatit, duhet të tregoni se autoritetet në vendin tuaj të origjinës nuk mund t'ju mbrojnë.

Nëse keni frikë nga autoritetet në vendin tuaj të origjinës, atëherë mund të duket e qartë se ato nuk mund t'ju mbrojnë. Megjithatë, ju duhet ende ta shpjegoni këtë. Nëse keni frikë nga dikush tjetër, atëherë gjatë intervistës për azil mund t'ju pyesin pse nuk mund të merrni mbrojtje nga autoritetet në vendin tuaj të origjinës, si p.sh. nga policia. Nëse nuk është e mundur ose është jorealiste që të kërkon mbrojtje nga autoritetet në vendin tuaj të origjinës, atëherë duhet të shpjegoni pse.

Logjika është - pse të largoheni nga vendi juaj dhe të vini këtu për të kërkuar azil, nëse mund të kishit marrë mbrojtje në shtëpi, nga autoritetet e vendit tuaj?

4

Nuk mund të shkoni askund tjetër në vendin tuaj të origjinës

Për të marrë statusin e refugjatit, duhet të tregoni se askund në vendin tuaj të origjinës nuk është e sigurt për ju. Gjatë intervistës për azil, mund t'ju kërkohet të shpjegoni pse nuk mund të shkoni në një pjesë tjetër të vendit tuaj, për të shpëtuar nga frika e persekutimit.

Nëse keni frikë nga autoritetet dhe ato autoritete janë në pushtet në të gjithë vendin tuaj të origjinës, atëherë mund të duket e qartë që nuk mund të jeni të sigurt askund. Megjithatë, ju duhet ende ta shpjegoni këtë.

Nëse mund të zhvendoseni në një zonë tjetër të vendit tuaj të origjinës, por do të përballeni me rreziqe ose probleme serioze edhe atje, duhet ta shpjegoni këtë gjithashtu. Nëse është e arsyeshme t'ju kërkohet të filloni një jetë të re jashtë zonës suaj të origjinës do të varet nga rrethanat tuaja individuale.

Për shembull, nëse jeni një burrë i vetëm, i arsimuar mirë, i shëndetshëm dhe me një rrjet të fortë familjar në vendin tuaj - ndoshta mund të sugjerohet që të shkoni dhe të filloni një jetë të re diku tjetër në vend. Nëse jeni një nënë e vetme me probleme të rënda shëndetësore, pa arsimim ose mbështetje familjare, mund të mos jetë e arsyeshme të sugjerohet që të shkoni dhe të filloni një jetë të re në një pjesë të panjohur të vendit tuaj të origjinës.

Logjika është - pse të largoheni nga vendi juaj dhe të vini këtu për të kërkuar azil, nëse mund të ishit të sigurt dhe të mbijetonit diku tjetër brenda vendit tuaj?

Vendimet për kërkesën tuaj për azil

Vendim negativ

Nëse kërkesa juaj për azil refuzohet, duhet të keni të drejtën për të apeluar. Do të ketë një afat për apelimin, prandaj është e rëndësishme të merrni këshillë ligjore sa më shpejt të jetë e mundur.

Vendim pozitiv

Nëse ju jepet statusi i refugjatit, kjo do të thotë që keni marrë një vendim pozitiv për kërkesën tuaj për azil dhe duhet të lejohet të qëndroni në vendin ku po kërkonit azil dhe të merrni një leje qëndrimi - zakonisht për një numër të kufizuar vitesh dhe me mundësinë e rinovimit.

Çdo vend është i ndryshëm, prandaj është e rëndësishme të merrni këshillë ligjore të personalizuar nëse është e mundur.

Ju urojmë fat të mirë!